



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 12 date 25 .01.2018

“ PER KLASIFIKIMIN E TRE BANESAVE , NE BANESA SOCIALE ”

Baza Ligjore:

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.139 /2015 “ Per veteqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”, neni 3 pika b , (i ndryshuar), ne VKM Nr.814 dt.03.12.2004 “ Per normat e strehimit per familjet qe perfitojne nga programet sociale te strehimit” , VKM Nr.574 date 29.08.2012 “per percaktimin e dokumentacionit qe duhet te paraqese familja per tu strehuar sipas njerit prej programeve sociale te strehimit, dhe procedurave te miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, ne VKM Nr.526 dt.06.08.2014 “ Per kategorite e personave me aftesi te kufizuara qe trajtohen me perparesi si perfitues te programeve sociale te strehimit”, Udhhezimin e Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit Nr.32 date 30.12.2008 “Per permbajtjen e bonusit te strehimit” si dhe urdherit Nr. 11 dt. 24.01.2018 te ngritur prane Bashkise Tropoje nga Kryetari i Bashkise per krijimin e komisionit te strehimit , vendosi:

- 1.Ti propozoje Keshillit Bashkiak Tropoje per klasifikimin e tre banesave (ne mungese te banesave sociale prane Bashkise Tropoje) ne pronesi te personave fizike si banesa sociale.
2. Keto banesa vihen ne dispozicion kur kemi raste emergjencash te ndryshme si dhe ne rastet kur jepen me qira per familjet qe perfitojne bonus strehimi.
3. Banesat qe vihen ne dispozicion jane:

- Apartament Lagje ‘ Partizani” me Nr i Pasurise 4/10+2-5 , me strukture 1+1 me siperfaqe 55 m2 ,
- Dy Banesa me Nr. Pasurie12/94 , zone Kadastrale 1347 ish – Zyrat e ndermarrjes perpunim drurit te pershtatura ne banese njera me strukture 2+1 me siperfaqe 70m2 dhe tjetra me strukture 1+1 me siperfaqe 54m2.

4. Çmimi i ketyre banesave do te jete sipas ofertave me te uleta dhe tipit te apartamentit por jo me te larta se ato te miratuara me VKB , nr 29 date 31.01.2017 , qe jane si me poshte:

- | | | |
|----------------------------------|--------------|-----------------|
| • Banese me strukture Grasoniere | vlere qiraje | 4000 leke/muaj |
| • Banese me strukture 1+1 | vlere qiraje | 7000 leke /muaj |
| • Banese me strukture 2+1 | vlere qiraje | 9000 leke /muaj |
| • Banese me strukture 3+1 | vlere qiraje | 12000 leke/muaj |

4. Kontrata e qirase lidhet qe nga nje dhjetori 2017 deri me 1 dhjetor 2018 (pasi keto banesa u moren ne dispozicion te familjeve qe u dogjen ne fillim te muajit dhjetor 2017 nga zjarri i rene ne kete pallat te lagjes “Dardania”) ne perputhje me ligjin Nr.9232 prot, dt 13.05.2004 “per programet sociale te strehimit te banoreve ne zonat urbane “ neni 10 pika 1 dhe 2.


5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Tropoje dhe Komisioni i strehimit per programet sociale per strehim prane Bashkise TROPOJE.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës.

Për Këshillin e Bashkisë Tropoje

Sekretari

Rubin SELLAJ



Kryetari

Imer HOÇI

